

*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

19.10.2024

Ora 12:08

***RENDI I DITËS***

**Projektvendimi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”**

**PJESE MARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregulator:**

• Ilirjana	NANO	Kryetar
• Arens	ÇELA	Anëtar
• Dritan	ÇAKA	Anëtar
• Helga	VUKAJ	Anëtar
• Muharrem	ÇAKAJ	Anëtar
• Stafi	KQZ	Znj. M. Çelmeta, znj.J. Josifi

**Parti Politike:** PD (Z.F. Nuri ), PS (znej. E. Xhina)

**OJQ:** KRIIK

**Znj. I. Nano:** Mirëdita! Rifillojmë mbledhjen e Komisionit Rregulator të ndërprerë ditën e djeshme, mbas disa kohësh diskutime, debate dhe miratimi të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike*

*të Komisionit Rregulator*

*Dt. 19.10.2024*

një pjese të tij. Projektvendimi “Për miratimin e rregullave dhe regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, ky ishte projektvendimi që po shqyrtonim dhe po shqyrtojmë. Kemi miratuar dy kërët e parë. Në kreun III e kemi lënë në momentin që z. Nuri, përfaqësues i Partisë Demokratike, ka bërë propozim konkret. Ndërkohë edhe znj. Vukaj, anëtare e Komisionit Rregulator, vlerësoi që do të bënte një propozim, nuk e ka bërë ende. Po meqë jemi te një propozim që është bërë aktualisht, z. Nuri, ju keni propozuar, është propozuar që në pikën 3, të kreut III, aty ku fillon procedura, pasi zgjedhësi ka krijuar llogarinë në platformën elektronike të regjistrimit, ndiqen disa hapa për të proceduar kërkesën, mes të cilave në projektaktin e propozuar parashikohet që zgjedhësi skanon në PER një dokument të vlefshëm identifikimi të lëshuar nga Republika e Shqipërisë, pasaportë për jashtë shtetit ose letërnjoftim. PER lexon dhe ngarkon automatikisht në platformë të dhënat që përmban dokumenti i identifikimit. Nëse për arsyet e ndryshme këto të dhëna nuk ngarkohen automatikisht, atëherë zgjedhësi i ngarkon ato në PER në mënyrë manuale. Në këtë moment ju keni bërë dy propozime, për të shtuar edhe një dokument tjetër siç është leja e drejtimit dhe për të hequr fjalën “të vlefshëm”. Përpara se t’ju jepja edhe njëherë fjalën doja të pyesja pak administratën lidhur me dokumentin leje drejtimi, mundëson, është i barasvlefshëm në kuptim të identifikimit? Gjithmonë nëse kemi parasysh edhe çfarë e bën PER-i, çfarë kërkon, çfarë identifikon, cilat të dhëna kërkon të përputhen, pra një leje drejtimi znj. Josifi i përmban këto të dhëna?

**Znj. J. Josifi:** Faleminderit për fjalën! Jo, leja e drejtimit nuk i përmban të gjitha të dhënat e identitetit, më saktë i mungon e dhëna kryesore që është numri personal i identifikimit të shtetasit.

*Zbardhi materialin audio*  
*Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Znj. I. Nano:** Çfarë do të pamundësonë nëse zgjedhësi do të paraqiste një leje drejtimi? Çfarë do të pamundësohej më tej nga platforma, ose nëse platforma do të kishte mundësi?

**Znj. J. Josifi:** Nuk do të mund të kontrollohen të dhënat, saktësia e tyre, përputhshmëria me të dhënat në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe gjithsesi nuk do të ishte as i mundur identifikimi unik i shtetasit. Pra, kemi shtetas që kanë të njëjtin emër, mbiemër, ndoshta dhe atësinë, ndoshta dhe datëlindjen që do t'i dallonte në këtë rast vetëm numri personal i identifikimit, i cili nuk gjendet në patentë. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Dakord. Z. Nuri nëse mundet të bashkëbisedojmë lidhur me këtë gjë, lidhur me lejen e drejimit, t'i marrim të dy propozimet me radhë. Si e vlerësoni? Sepse ne vërtet e ndërpremë edhe dje po kemi vijuar me diskutimet sikundër thamë, kështu që minimalisht për këtë pjesë kontrolluam leje drejtimi vetë dhe pamë çfarë të dhënash përmban.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Po faleminderit! E qartë! Në këto kushte kur administrata sapo e konfirmoi që dokumenti i lëshuar nga Republika e Shqipërisë, leje drejtimi nuk mundëson identifikimin me numër unik të shtetasit, për ta bëre më të thjeshtë dhe eventualisht votuesit, atëherë t'i qëndrojmë parashikimit të Kodit, neni 44 që flet për dokument identifikimi.

**Znj. I. Nano:** Duke pasur parasysh pasaportën dhe kartën e identitetit.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Insistoj dhe njëherë për efekt sqarimi që ne jemi si Parti Demokratike me idenë që të hiqet togfjalëshi “të vlefshme”.

**Znj. I. Nano:** Dakord.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Jemi në proces regjistrimi, identifikimi dhe regjistrimi të zgjedhësve me banim jashtë vendit dhe nuk është e domosdoshme dhe e detyrueshme edhe në bazë të Kodit Zgjedhor në interpretimin tonë që zgjedhësit nga jashtë shtetit të trajtohen ndryshe nga zgjedhësit në Shqipëri për efekt të regjistrimit të tyre. Zgjedhësit në Shqipëri përfekt përfekt të regjistrimi mjafton që t'i kenë ato kriteret ligjore, të mbushin moshën, t'i jenë shtetas shqiptarë e me radhë, që i ka t'i parashikuara Kodi Zgjedhor dhe në këto kushte nuk janë pse zgjedhësit me banim jashtë shtetit t'i kenë dokumentat e vlefshëm në datën e regjistrimit, në këtë platformë. Ata mund t'i jenë në proces rrinovimi të dokumentave ose hipoteza më eventuale është edhe ajo që ka ndodhur në zgjedhjet e shkuara, ku Këshilli i Ministrave me akt normativ ka miratuar që, është marrë vendimi që vlefshmëria e dokumentave të identifikimit të zgjatej. Nëse kjo hipotezë ndodh në zgjedhjet e 2025 dhe ky vendim merret një muaj para zgjedhjeve, atëherë kur do jetë i mbyllur procesi i regjistrimit të votuesve nga jashtë, se mbylljet 62 ditë përpëra datës së votimit, atëherë i bie që praktikisht të gjithë këta votues që janë me banim jashtë shtetit dhe nuk mund t'i kenë pasur mundësi të regjistrohen, i bie që ata s'do votojnë dot. Kështu që përfekt t'i shbangur këtë risk, unë i qëndroj dhe njëherë idesë që dokumentat e identifikimit mos t'i përcaktohen t'i jenë "të vlefshme" apo jo, por thjesht t'i shënohet dokument identifikimi, sipas parashikimeve të Kodit. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Nëse më lejoni ta vijoj diskutimin. Pra, duke propozuar t'i hiqet togfjalëshi "të vlefshme", në eventualitetin që votohet ky amendamet që ju propozoni, pra mbetet dokument identifikimi, që nënkupton dhe i pavlefshëm në momentin e regjistrimit. Momenti i regjistrimit fillon, periudha e regjistrimit fillon 120 ditë para ditës së zgjedhjeve. Si mendoni se mund t'i votojë ky shtetas? Sepse duhet t'i shtojmë gjithë rrjedhën e veprimeve që kryhen, pra në akt, në projektaktin

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

që ne kemi në shqyrtim. Pas momentit të regjistrimit, vijojmë me shqyrtimin e kërkesave, me krijimin e listës së zgjedhësve, në momentin që kemi listën e zgjedhësve 63 ditë para dhe kemi shtetas të regjistruar në momente të caktuara, 120 ditë deri në 63 ditë, të cilët mund të jenë regjistruar me kartë ose me pasaportë, pra me dokument identifikimi të pavlefshëm, në kuptimin që i ka kaluar afati i vlefshmërisë, si mendoni se mund të ndodhë më pas? Si mundet të votojnë më tej këta shtetas, me një dokument të pavlefshëm, si mendoni? Se duhet të shohim dhe pasojat, jo pasoja, po çfarë na sjell miratimi i këtij momenti?

**Znj. H. Vukaj:** Znj. Nano mendoni se ky diskursi duke marrë në pyetje z. Franc do të na jepte mundësinë të ndryshojmë Kodin apo mundësinë që të kemi perceptime të tjera për parime që ne vetë i miratuam dje? Ne miratuam dje parimin e gjithëpërfshirjes dhe të barazisë dhe ndërkohë sot ne po marrim në pyetje një përfaqësues të një partie politike. Zotëria e shprehu mendimin e tij, mendoj që duhet të vijojmë radhën e diskutimeve apo të propozimeve të tjera. Nuk ka nevojë për ta marrë në pyetje, në test z. Nuri.

**Znj. I. Nano:** Z. Nuri dhe Partia Demokratike që ka përfaqësues z. Nuri nuk besoj se ka nevojë për avokati tjetër nga ana jonë. Unë po e pyes kolegun e nderuar...

**Znj. H. Vukaj:** Z. Nuri është tërësisht i respektuar dhe në gjendje që të japë përgjigje shumë pyetjeve, problemi është po diskutoj diçka banale te pjesa, që e merr në pyetje z. Nuri. Më duket si diçka banale që e merr në pyetje z. Nuri apo zonjën...

**Znj. I. Nano:** Të lutem znj. Vukaj, mos e banalizo. Unë nuk marr në pyetje z. Nuri.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Znj. H. Vukaj:** ...nuk di mbiemrin e zonjës, nuk na u bë një prezantim i mbiemrit të zonjës...

**Znj. I. Nano:** Zonja Elena Xhina, përfaqësuese e Partisë Socialiste...

**Znj. H. Vukaj:** ...zonjës përfaqësuese të Partisë Socialiste dhe me këdo do ta bëja ndërhyrjen.

**Znj. I. Nano:** Pra, unë vlerësoj personalisht që nëse ne bëjmë një ndryshim në projektakt, duhet të shohim çfarë na sjell, duhet të shohim hapat e mëvonshëm dhe unë e kam këtë merak, për të ditur se çfarë na sjell kjo. Pra, nga ky moment shkojmë deri tek lista e zgjedhësve, fillon ky moment nga 120 ditë deri në 63 ditë.

**Z. M. Çakaj:** Më falni zonja Nano!

**Znj. I. Nano:** Po.

**Z. M. Çakaj:** Atëherë, ju po shkelni rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Komisionit Rregulator. Ajo çështje që ju shtroni ka të bëjë me votimin dhe votimin nuk e kemi në rend dite, është një akt tjetër. Nga ana tjetër në rregulloren tonë nuk parashikohet që ju të bëni bashkëbisedim por partitë politike, përfaqësuesit e tyre mund të bëjnë propozime, po jo bashkëbisedim. Bashkëbisedim, pyetje, përgjigje, informacione e kemi vetëm me administratën. Të lutem shikojeni rregulloren, respektojeni! Po dalim jashtë rregullores!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Gjithsesi dhe në respekt të Kryetares, unë do e ripërsëris dhe njëherë dhe po e sqaroj dhe njëherë qëndrimin e Partisë Demokratike në lidhje me këtë pikë. Duhet të kuptojmë të gjithë që jemi në fazën e regjistrimit të zgjedhësve nga jashtë, nuk jemi në fazën e votimit dhe sikundër


*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

për të gjithë zgjedhësit në Shqipëri kur hartohen listat e zgjedhësve janë dhe figurojnë mbi 3 apo 4 milion zgjedhës aktualisht, pavarësisht se në Shqipëri banojnë, sipas censusit 2.2 milionë banorë. Janë të regjistruar dhe ata që s'kanë dokumenta identifikimi fare në listat e zgjedhësve ose që dhe nuk kanë lindur fare në Shqipëri, por prindërit i kanë regjistruar në Gjendjen Civile dhe raste dhe personale që jetojnë raste prej vitesh dhe nuk kanë pasur kurrë asnje dokument identifikimi të Republikës së Shqipërisë, kartë apo pasaportë, por janë raste sporadike. Ajo që ne duhet të theksojmë dhe njëherë është që te fazë e regjistrimit nuk është se KQZ-ja mund t'i pengojë, me këtë platformë. Ata zgjedhës që sot ndodhen jashtë shtetit por dokumenti u ka skaduar, pra në fazën e regjistrimit të dokumentit nuk është akoma i vlefshëm, i ka kaluar data, nuk kemi pse t'i pengojmë të regjistrohen. Le të regjistrohen, është e drejta e tyre, të figurojnë në listën e zgjedhësve nga jashtë, sikundër figurojnë dhe këtu në Shqipëri te listat e zgjedhësve në Shqipëri dhe më pas nëse këta shtetas për të ushtruar të drejtën e tyre të votës do të marrin masat për të rinovuar dokumentat e tyre, është e drejta e tyre, pse t'i pengojmë ata që të votojnë eventualisht. Kjo është hipoteza normale, por kemi dhe rastin e përjashtimit nga këto rregulla që e theksoj dhe njëherë ka ndodhur në disa palë zgjedhje, ku me akt normativ, Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave i ka dhënë të drejtën shtetasve në Shqipëri të votojnë edhe me dokumenta identifikimi të skaduara, nëse do të ndodhi ky eventualitet pastaj nuk mund të ketë më kthim mbrapsht për këta zgjedhës nga jashtë. Praktikisht atyre u mbyllët e drejta e votimit, në mënyrë të njëanshme dhe kësisoj shkelet barazia e votës sepse i bie që në zgjedhjet e 2025, nëse gjithmonë nëse do merret ajo VKM-ja që do t'i shtojë vlefshmërinë, po ecim me këtë rast, sepse ka ndodhur në zgjedhjet e shkuara, nuk mund ta përjashtojmë në këtë rast këtë hipotezë do të thotë që të shkelet barazia e votuesve sepse zgjedhësit në Shqipëri me dokumenta

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

të skaduara do të kenë të drejtë të votojnë, zgjedhësit shqiptarë jashtë me dokumenta të skaduara s'do të kenë të drejtë të votojnë, është kaq e thjeshtë. Ndaj unë mendoj që le të regjistrohen të gjitha ata që kanë dëshirë të regjistrohen në platformë, tek PER-i dhe më pas për pjesën e votës në një moment të dytë do të shihet patjetër.

**Znj. I. Nano:** Z. Nuri ju falenderoj shumë!

**Z. F. Nuri, përfaqësues i PD:** Edhe një fjali për ta mbyllur. Mund të ketë dhe mekanizma për të kontrolluar në një moment të dytë nëse dokumenti në platformë upload-het dokumenti i përditësuar, dokumenti i rinovuar përpara nisjes së materialeve zgjedhore, mund të ketë mekanizma të ndryshme që ju si Rregulator apo KQZ-ja mund t'i vendosin në jetë dhe mund t'i implementojnë, pse jo. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Atëherë le të jem e qartë, e para për kolegët por edhe për publikun, ky diskutim bëhet për hir të një transparence të shtuar, janë jo pak njerëz që na dëgjojnë dhe na shohin. Ky është një moment krucial, pra është akti i parë që po miratojmë për regjistrimin e zgjedhësve dhe nëse nuk i vëmë pikat mbi i që këtu për mënyrën e regjistrimit, për dokumentacionin, për hapat që duhen hedhur. Mendoj që nëse këto i vendosim mirë tani, çdo hap tjetër do ta kemi më të lehtë dhe padyshim unë nuk them, unë personalisht bie dakord me ju për këtë moment të regjistrimit. Pra, në momentin e regjistrimit mund të jetë edhe një dokument që nuk është i vlefshëm, në atë moment, por mua më shqetëson dhe e lidh këtë moment me momentin e votimit z. Nuri, prandaj doja të dija, ndoshta dhe nga përfaqësuesi i partisë tjetër, ndoshta dhe nga kolegët, sepse në fund të fundit kemi dy subjektit kryesore të përfaqësuara këtu. Pra, nuk jemi duke thënë që në momentin e regjistrimit, absolutisht i vlefshëm, mendoj dhe vlerësoj që është vënë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

këtu se nuk është gjetur në akt një moment tjetër ku ne ta kemi vlefshmërinë prandaj le të vlerësojmë po brenda këtij akti. Këtu jemi deri në momentin e hartimit të listës së zgjedhësve dhe ky është moment final sa i përket problematikës së regjistrimit dhe të dhënies të të drejtës qytetarit, më tej procesi është administrativ, ço zarfin, merr zarfin. Pra, deri në këtë moment kur del, publikohet lista përfundimtare e zgjedhësve ne duhet ta zgjidhim nëpërmjet një hallke proceduriale atë që Kodi Zgjedhor na kërkon, pra faktin që votuesi duhet të votojë me një dokument identifikimi të vlefshëm. Pra, nëse ne e heqim nga momenti i regjistrimit brenda këtij akti ku kemi listën, ku mund ta vendosim, ku mund ta akomodojmë këtë gjë sepse duhet, po mbaroi lista e zgjedhësve ne nuk mund ta lëmë në dorë të, nuk e di, kujdo që do merret me dërgimin e zarfave. Pra, në këtë moment mund ta heqim, por domosdoshmërisht duhet ta vendosim në një moment procedural për vlefshmërinë për të votuar dokumentet e identifikimit duhet ta vëmë në këtë akt z. Nuri, prandaj ju drejtova ju, kërkoj ndjesë, po duke qenë se bëtë këtë propozim mendoj nëse mund të vlerësoni një propozim ku mund ta vendosim këtë tjetrën që t'i kemi në një akt të dyja. Po zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Faleminderit për transparencën znj. Nano, po vijojmë përsëri për hir të parimit të transparencës t'i bëj me dije të gjithë qytetarët brenda dhe jashtë Shqipërisë të cilët me padurim presin...

**Znj. I. Nano:** Kjo është në përputhje me rregulloren, t'iu bësh thirrje qytetarëve, se kur flas me pjesëmarrësit në sallë bie në kundërshtim me rregulloren!

**Znj. H. Vukaj:** ...dhe në emër të interesit publik unë u bëj thirrje qytetarëve të kenë vëmendjen që ne për ta dhe në emër të tyre miratuam dhe jemi këtu dhe po funksionojmë në emër të interesit publik, pra në emër të tyre dhe kam gjithë të drejtën t'i bëj thirrje të kenë vëmendjen që kjo është një e drejtë kushtetuese, ia ka

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 19.10.2024*

dhënë kushtetuta, nuk mund t'ia mohojë në mënyrë subjektive askush, e para. E dyta, për hir të transparencës, asnje nga përfaqësuesit politik aty, qoftë përfaqësuesja znj. Xhina apo përfaqësuesi z. Nuri, nuk mund të marrin përsipër mëkatet e këtij shteti, i cili nuk ka një database (bazë të dhënash) të të gjithë të larguarve jashtë shtetit dhe po kërkon dhe po ju kujtoj dhe njëherë që është rendi i ditës të krijojmë listën e zgjedhësve. Pra, të krijojë statistikën në fund të fundit dhe për statistikën në fund të fundit mjafton një dokument i cili dëshmon se ky është shtetas shqiptar dhe ka një ID përkatëse, ka një numër i cili identifikohet dhe ekziston në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Ky është rendi i ditës znj. Nano, mos të kapërcejmë në rende të tjera të cilat nuk dimë se si dhe madje po i paragjykojmë që tani. A janë propozimet e z. Celibashi? I cili, e përsëris, duhet të ishte këtu sot dhe nuk duhet t'i shmanget kësaj mbledhje, nuk kemi pse t'i adresohemi administratës, e cila është njësoj si për z. Celibashi, presupozohet të jetë njësoj, ashtu si dhe për ne. Duhet të ishte z. Celibashi këtu, i cili është përfaqësuesi me palët e tretë, i cili ka bërë demo apo ka mbajtur disa pretime, le të themi, apo ka parashtruar situatën si mendon ta zgjidhi përpara grupit të dialogut. Kështu që t'i përmbahemi rendit të ditës dhe njëherë dhe të kujtojmë parimet që ne vetë miratuam dje, me gjithë vullnetin e plotë, të të gjitha palëve, ku thamë që do të jetë masiv, pra, gjithëpërfshirës dhe i barabartë. Shtetasit shqiptarë janë të barabartë kudo ku ndodhen. Problemin tënd, edhe njëherë e përsëris, që ti nuk ke një regjistër sesa individë ke zgjedhës jashtë shtetit, kjo nuk është çështje e tyre dhe nuk mund të disikriminojë ata. Për hir të një dokumenti, që e dimë shumë mirë, që i pamundësohet përsëri nga strukturat shtetërore të ndodhura jashtë vendit apo ndodhen ata në pamundësi sepse mund të jenë emigrantë jolegalë, për hir të kushteve ekonomike apo politike në këtë vend, kështu që t'i rrimë rendit të ditës dhe të vazhdojmë me propozimet!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 19.10.2024*

**Z. M. Çakaj:** Më falni!

**Znj. I. Nano:** Po z. Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Atëherë, referuar çështjes që na është shtruar për shqyrtim, pra projektakti, projektvendimi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e listës së zgjedhësve”. Kemi një propozim konkret. Atëhere vlen të theksoj paraprakisht që propozimi në pikën 3, në kreun III, pikën 3, shkronja “a”, të projektaktit të propozuar, unë personalisht e gjej totalisht të pabazuar në Kodin Zgjedhor. Pse e them këtë? Pra, fare mirë mund të themi i paligjshëm, propozimi i z. Celibashi, për më tepër që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka qenë përpara grupit të dialogut, ka prezantuar gjithë projektaktin dhe është materializuar me formulimin, me ndryshimet e datës 26 korrik. Nëse ligjvënësi do të kishte vullnetin për të ndryshuar nenin 44, të Kodit Zgjedhor, ku bëhet fjalë për kriteret përfshirjen e një zgjedhësi në listat e zgjedhësve dhe këtu nuk cilësohet një dokument identifikimi i vlefshëm, apo më tej akoma për transparencë edhe mund ta lexoj: “Kriteret përfshirjen e një personi në listën e zgjedhësve janë a) të ketë shtetësinë shqiptare b) të ketë mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në datën e zgjedhjeve, (pika c) është shfuqizuar) ç) të jetë i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile d) të ketë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave zgjedhore e zonave të qendrave të votimit dh) të regjistrohet zgjedhës në listën e vetëm një zone, qendre votimi.” Pra, nuk kemi asgjëkundi këtu vlefshmërinë e dokumentit dhe të gjithë e dimë që regjistri pasiv i zgjedhësve nuk ka asnje ndërveprim me zgjedhësin, automatikisht shtetasi shqiptar parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë që ka mbushur moshën 18 vjeç ka të drejtën për të votuar dhe automatikisht përfshihet në listën e

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 19.10.2024*

zgjedhësve. Më tej akoma në nenin 46 lista e zgjedhësve, pika 3, që bën fjalë posaçërisht për listën e zgjedhësve nga jashtë vendit, parashikohet lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 të këtij ligji. Pra, nuk parashikohet asgjékundi në Kodin Zgjedhor që shtetasi i cili do të përfshihet në listën e zgjedhësve jashtë vendit mjafton të deklarojë vullnetin dhe kjo është lehtësi. Paraqitja e një dokumenti identifikimi të lëshuar nga Republika e Shqipërisë në raport me PER-in, nuk thotë asgjékundi “të vlefshëm”. Pra, nëse shtetasi shqiptar që ndodhet në Shqipëri e ka, përfshihet automatikisht në listën e zgjedhësve, shtetasi shqiptar që ndodhet jashtë vendit mjafton të deklarojë vullnetin. Tani, nëse ju kërkonit të mbroni, përfshirë dhe z. Celibashi që ka bërë propozim të paligjshëm, kërkonit të mbroni një diçka e cila nuk është parashikuar në Kod, më vjen keq po unë s’ë pranoj personalisht këtë gjë. Është e paligjshme të kërkosh që shtetasi shqiptar me banim jashtë shtetit të ketë një dokument të vlefshëm identifikimi. Me gjeni një bazë ligjore dhe hajde ta votojmë të gjithë së bashku! Është e paligjshme! Kështu që mos insistoni kot. Për sa i përket të drejtës së votës, procesit të votimit, kjo është në një moment të dytë. Kur të vijë akti, ne të gjithë së bashku me përfaqësuesit e partive politike gjejmë një mënyrë operimi, gjejmë një mundësi se si të respektohen dhe kërkesat e Kodit Zgjedhor, si të respektohet dhe e drejta kushtetuese e votës. Faleminderit e nderuar!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit! Z. Çaka! Znj. Xhina kishit kërkuar dhe ju fjalën më herët? Po mbas z. Çaka ju lutem.

**Z. D. Çaka:** Faleminderit znj. Nano. Padyshim që jeni të gjithë dakord për rëndësinë e këtij procesi dhe duhet që të akomodojmë sa më shumë zgjedhje të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

lira për çdo qytetar dhe mbi të gjitha të kemi sa më shumë lehtësira për qytetarët, si ata që ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe ata që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Patjetër që në disa çështje mund të bie dakord me diskutimet dhe me kolegët që mbështetin që në momentin që në momente të caktuara do të kishte qenë më mirë që e gjithë paketa e akteve të shqyrtohej dhe mbështetin që kjo do të akomodonte edhe shqetësimet që ngrihen këtu, mbi fazat të ndryshme të procesit të regjistrimit, por dhe të votimit të shtetasit me banim në jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por sot e kemi të pamundur që të funksionojë dhe hallkat e këtij procesi nuk janë të ndërpresa. Në thelb rëndësi nuk ka vetëm fakti nëse një shtetas regjistrohet, në vlerësimin tim, regjistrohet apo jo në listën e zgjedhësve por qëllimi final i këtij procesi është që zgjedhësi të votojë dhe vota e tij të vlerësohet dhe numërohet ashtu siç ka qenë vullneti i tij. Nuk ka rëndësi sesa etapa ne ndjekim përpara, edhe nëse, nuk ka rëndësi nëse regjistrohet një zgjedhës apo jo, rëndësi ka a do të votojë ky zgjedhës apo jo? Kjo është e rëndësishme për zgjedhësin, për ne si Komision Rregulator por dhe për vetë shtetin shqiptar duhet të jetë. Kështu që unë mendoj që absolutisht që nuk mund të ndahanë të gjitha proceset dhe nuk mund të shihet çdo gjë e bardhë apo e zezë sepse nuk jemi në të njëjtat kushte me një proces regjistrimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe një proces votimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Për shtetasit brenda Shqipërisë kemi një proces të gjatë regjistrimi, i cili përfundon me një listë zgjedhësish diku dy muaj përpara datës së votimit dhe kemi një datë fiksë votimi dhe zgjedhësi është i përgatitur që dy muaj përpara me këtë proces. Është apo s'është në listë. Në qoftë se nuk është ose ka pasaktësi i mundësoshet nëpërmjet rrugëve gjyqësore për ta rregulluar këtë gjë. Ndërkohë në një proces votimi shtetasit që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nuk mund të jemi njësoj. Në momentin që 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

publikuar, zyrtare, po flasim, për shtetasin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë kemi një listë përfundimtare për votuesin që ndodhet jashtë, data e zgjedhjeve mund të fillojë dhe pas një javë, nga ky moment. Nuk ka dy muaj kohë zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë detyrimisht për të votuar sepse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund t'ia nisi dhe pas 12 ditësh ose 11 ditësh zarfin me fletën e votimit dhe atij që ajo ditë i fillon dita e votimit. Ai e ka të drejtë që në atë moment, pra, nuk jemi në të njëjtat kushte. Duhet të kuptojmë që kemi një afat vetëm 10 ditor në hipotezë që mundet të ndodhi një rregullim i dokumentit të identifikimit. Po pyetja ime është çfarë do të ndodhi me ata zgjedhës të cilët ne në mënyrë hipotetike i pompojmë, i fryjmë, u themi u krijuam platformën, jeni regjistruar, do votoni dhe në fund të ditës ata nuk do të kenë të drejtën të votojnë sipas Kodit sepse unë kështu e lexoj, që ditën e votimit, pra në 49 ditë përpara datës së zgjedhësve ai mund të mos votojë nëse nuk e ka një dokument të vlefshëm sepse e thotë neni 105 i Kodit Zgjedhor, nuk e themi ne dhe ne nuk mundet ta zhbëjmë këtë gjë. Atëherë çfarë do ndodhi? Do ta investojmë këtë qytetar? Sepse në Shqipëri një qytetar i cili regjistrohet automatikisht nuk investohet, nuk aplikon në një platformë, nuk kërkohet një dokument për t'u ngarkuar, pra është komplet pasiv, nuk ka një investim, ndërkohë çfarë do ndodhi me atë qytetarin që ne do t'i themi që ne të regjistruam, ti nuk voton dot. Pra, për mua është një gjysëm gënjeshtre dhe mendoj që, që në këtë moment ne duhet të marrim masa për të parashikuar disa etapa që dhe qytetarët të jenë të vetëdijshëm që nëse nuk plotësojnë disa kritere patjetër nuk mund të votojnë. Jo sepse e mohojmë ne, me të vërtetë është kushtetuta që na i jep ne të gjithë këtë të drejtë por ka edhe disa cënime të kësaj të drejte. Këto cënime i ka vendosur Kodi dhe këto janë kufizime që lidhen me dokumenta identifikimi ose dhe me procese të tjera dhe ne nuk mundet ta legjитимоjмë një gjë të tillë, ama

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

ne kemi të drejtën që të krijojmë sa më shumë garanci dhe t'ju japim atyre sa më shumë mundësi. Në lidhje me një vlerësim që z. Nuri bëri. Me të vërtetë mund të ndodhi që të kemi një shtyrje të afatit, ama kjo shtyrje nuk është në vullnetin tonë. Ne thjesht mundet ta mendojmë në mënyrë hipotetike siç ka ndodhur në zgjedhjet e mëparshme, por dhe në zgjedhjet e mëparshme, ne nuk mund t'i fusim në vlerësim duke pasur parasysh dhe duke analizuar historikun e këtyre akteve normative për shtyrjen e vlefshmërisë së dokumentave të identifikimit. Vlefshmëria nuk është shtyrë në bllok, për çdo dokument i cili ka skaduar por është shtyrë për një fashë kohore të caktuar. Pra kujt i ka skaduar 6 muajt e fundit, kujt i ka skaduar vitin e fundit, ndërkokë në qoftë se ne do ta hapim thesin e madh për çdo dokument identifikimi dhe të mendojmë që mund të shtyhet edhe për dikë që mund t'i ketë skaduar përpara 8, 9 apo 10 vjetëve në vlerësimin tim, unë nuk e marr përsipër që ta bëj dot këtë parashikim.

**Z. M. Çakaj:** Jemi jashtë rendit të ditës.

**Znj. I. Nano:** Jemi te lista e zgjedhësve.

**Z. M. Çakaj:** Është automatike lista e zgjedhësve, nen 45 i Kushtetutës thotë shtetasi që i ka mbushur 18 vjeç, qoftë dhe ditën e zgjedhjeve ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet. Çfarë kuptimi ka kjo? Po ti i diferencon shtetasit shqiptar që janë jashtë vendit kanë të drejta të kufizuara thua, ata që janë në Shqipëri...

**Z. D. Çaka:** Z. Çakaj ju lutem, unë nuk ju ndërprena.

**Znj. H. Vukaj:** Të nderuar kolegë, kthejuni rendit të ditës, i cili ka të bëjë me krijimin e regjistrat.

**Z. D. Çaka:** Mos të bëjmë zhurmuesin, unë nuk ju ndërprena.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 19.10.2024*

**Znj. H. Vukaj:** Nuk po bëjmë zhurmuesin. Ke dalë jashtë rendit të ditës i nderuar dhe përsëri me gojën tënde...

**Z. D. Çaka:** Absolutisht nuk kam dalë jashtë rendit të ditës. Nuk e përcaktoni ju rendin e ditës. Ju lutem nuk ju ndërpreva.

**Znj. H. Vukaj:** Ke dalë jashtë rendit të ditës zotëri, nuk diskutojmë akte të paqena. Për sa kohë administrata nuk ka sjellë akte apo paketë aktesh të cilat janë në sinkron nga 1...

**Znj. I. Nano:** Znj. Vukaj, ju lutem shumë. Nuk jemi këtu për të mashtruar qytetarët.

**Z. D. Çaka:** Nëse ne duam të mashtrojmë qytetarët..

**Znj. H. Vukaj:** Ju po i mashtroni qytetarët...

**Z. D. Çaka:** Nga njëra anë i thoni do votoni, s'do votoni.

**Znj. I. Nano:** Qytetari nuk voton dot pa një kartë identiteti të vlefshme apo pasaportë.

**Z. D. Çaka:** Do të kisha një propozim...

**Znj. H. Vukaj:** Ne jemi në fazën e regjistrimit.

**Z. D. Çaka:** Patjetër, dëgjoje deri në fund.

**Znj. H. Vukaj:** Sapo i demoralizove me fjalitë e tua të gjithë qytetarët, u the që kjo është një gjysëm gënjeshtre

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Znj. I. Nano:** Do jua ngresh ti moralin nesër, s'ka problem.

**Z. D. Çaka:** Jo unë shtrova një pyetje, çfarë do ndodhi në këtë moment.

**Znj. H. Vukaj:** Morali, e kanë në Kushtetutë ata zonjë, nuk ua ngre unë moralin atyre. E ka në Kushtetutë dhe léri të regjistrohen.

**Znj. I. Nano:** Në Kod Zgjedhor...

**Z. D. Çaka:** Qytetari i cili nuk ka një dokument të vlefshëm, nuk voton dot.

**Znj. H. Vukaj:** Léri të regjistrohen, léri të identifikohen, pastaj kalojmë dhe vlerësojmë se çfarë përbën akti i votimit

**Znj. I. Nano:** Ju lérini të regjistrohen...

**Znj. H. Vukaj:** Ju i demoralizuat shqiptarët sot me gjysmë gënjeshtren tënde të sapo përmendur.

**Z. D. Çaka:** E kuptioni se çfarë po thoni ju tani? Ju doni t'i fusni dhe pastaj mos të votojnë në qoftë se nuk kanë një dokument të vlefshëm. E ka përcaktuar, e ka vlerësuar Kodi...

**Z. M. Çakaj:** E kuptioni çfarë po bëni ju tani? Ata, kur të vijmë te akti do ta zgjidhim ne. E keni aktin përpara?

**Znj. I. Nano:** Unë kam një pyetje z. Çakaj, do votojnë apo s'do votojnë?

**Z. M. Çakaj:** Ata, kur të vijmë te akti do ta zgjidhim ne. E keni aktin përpara?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Z. D. Çaka:** Nuk zgjidhimi ne, e zgjidh Kodi Zgjedhor atë pjesë. E ka të zgjidhur Kodi Zgjedhor.

**Znj. I. Nano:** Në aktin e votimit ne nuk do bëjmë deklarata, ne do vëmë procedura, kështu që akti i votimit do të vijë mbasi të ketë përfunduar lista e zgjedhësve, jo në kohë po në kohë. Mbasi të ketë përfunduar lista do të kryhet procesi i votimit. Akti i votimi mund të vijë dhe mbas pak ditësh, por pa e saktësuar...

**Z. M. Çakaj:** Ke dijeni ti për aktin e votimit se unë s'kam dijeni, unë s'kam një draft para.

**Znj. I. Nano:** Kam matricën që na kanë dërguar.

**Z. M. Çakaj:** Për përmbajtjen e aktit?

**Znj. I. Nano:** Për përmbajtjen jo, po sigurisht që kam një koncept, se jam juriste dhe jam Kryetare e Komisionit Rregulator.

**Z. M. Çakaj:** Pse e paragjykon procesin ti?

**Znj. I. Nano:** Cilin proces?

**Z. M. Çakaj:** Procesin e votimit të zgjedhësit nga jashtë vendit? Ia japim ne të drejtën.

**Z. D. Çaka:** Jo, s'ia japim ne, ia ka dhënë Kodi.

**Z. M. Çakaj:** Ia ka dhënë Kodi, ne do materializojmë aktin, ju po e pengoni.

**Z. D. Çaka:** Jo.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Znj. I. Nano:** Nuk po e pengojmë fare..

**Z. M. Çakaj:** Nëse ju, më fal, nëse ju më gjeni një parashikim në Kod Zgjedhor, që zgjedhësi të përfshihet në listën e zgjedhësve duhet të ketë dokument identifikimi të vlefshëm, hajde ta votojmë të gjithë së bashku, po nëse Kodi Zgjedhor nuk e ka, ju pse e kërkon? Kjo është parashikim i paligjshëm. Këtë po mundohem t'ju them.

**Znj. I. Nano:** Mos u mundo sepse e kuptojmë këtë që thua.

**Z. M. Çakaj:** Sepse në raport me të drejtën, me përfshirjen e listës së zgjedhësve, të zgjedhësit brenda vendit është automatikisht. Ju e dini që Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në informacionin që na ka sjellë ne ka parashikuar që ka shtetas të cilët janë në listën e zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë dhe s'janë pajisur kurrë me dokument identifikimi por janë në listën e zgjedhësve. Pra, në Shqipëri kjo pabarazi mjafton të lindësh, mjafton të mbushësh moshën 18 vjeç, automatikisht bëhesh pjesë e listës. Apo jo e nderuar administratë? Ma konfirmoni këtë gjë?

**Z. D. Çaka:** A mundet ta vazhdoj të lutem?


**Z. M. Çakaj:** Ja një sekond ta mbaroj pastaj...

**Znj. I. Nano:** Ju e ndërpretë, nuk e mbaruat fjalën...

**Z. M. Çakaj:** A mund të ma konfirmoni këtë gjë? Se kështu e ka Kodi. Nëse shtetasi shqiptar ka mbushur moshën 18 vjeç, a është automatikisht pjesë përbërëse e listës së zgjedhësve?

**Z. D. Çaka:** S'kemi nevojë të na e konfirmojë këtë pjesë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Znj. J. Josifi:** Në listën brenda vendit...

**Z. M. Çakaj:** Në listën e zgjedhësve brenda vendit, s'e kemi krijuar jashtë vendit. Një listë zgjedhësish kemi sot.

**Znj. J. Josifi:** Nuk ka nevojë për regjistrim është pasive lista e zgjedhësve, ndërsa jashtë vendit është aktive.

**Z. D. Çaka:** Po pra është aktive se do investohen.

**Z. M. Çakaj:** Shumë dakord! Një sekond, tani në nenin 46 të Kodit Zgjedhor të cilat pësuan ndryshime me dakordësi të palëve politike, jo më vonë se para 3-4 muajsh, në datën 26 korrik u miratua, në nenin 46 parashikohet në mënyrë shteruese se lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me banim jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 të këtij ligji. Pra, deklaron vullnetin. Nëse ligjvënësi do të kishte ndërmend të vendoste disa kritere, do t'i përfshinte kriteret, nuk ka vendosur asnjë kriter, asnjë kufizim, pikërisht se ka parasysh të drejtën kushtetuese të parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës që çdo shtetas shqiptar që mbushur moshën 18 vjeç ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, nuk ka asnjë kufizim dhe nëse ne biem dakord që kjo se e drejta e votës është e barabartë, të drejtën e votimit ...

**Z. D. Çaka:** Jo

**Znj. I. Nano:** Lexo 25/1 që thotë ka të drejtë..

**Z. D. Çaka:** Jo, një zgjedhës me dokument të skaduar

**Z. M. Çakaj:** Jemi në listën e zgjedhësve të nderuar kolegë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Z. D. Çaka:** A mundem ta mbaroj?

**Z. I. Nano:** Ta mbarojë z. Çaka, pastaj znj. Xhina që ka kërkuar fjalën.

**Z. D. Çaka:** Pra, çfarë doja të thoja? Se në qoftë se ne në mënyrë hipotetike do t'ju japim, do ta fusim automatikisht në listën e zgjedhësve votues jashtë, një qytetar i cili banon jashtë por nuk ka në listën e votimit një dokument të vlefshëm ne në atë moment i kemi mohuar po një të drejtë tjetër, i kemi hequr të drejtën që ai... Zonja Vukaj, të lutem...

**Znj. H. Vukaj:** E ke paragjykuar që në fillim...

**Z. D. Çaka:** Nuk e kam paragjykuar sepse unë e heq automatikisht nga lista e votuesve në Shqipëri dhe i mohoi atij të drejtën që në 60 ditëshin e fundit ai të bëjë të vlefshëm këtë dokument dhe të vijë të votojë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Pra për ju është e rëndësishme 60 ditëshi i parë, ndërkohë 60 ditëshi i fundit që ne ia mohojmë atë të drejtë atij personi, nuk është e rëndësishme. Jo ...

**Z. M. Çakaj:** Më fal, të lutem si ia mohon të drejtën?

**Z. D. Çaka:** Ja ta sqaroj unë, në qoftë se vjen një zgjedhës me dokument të pavlefshëm...

**Z. M. Çakaj:** Nëse zgjedhësi me banim jashtë vendit ka shprehur vullnetin për t'u regjistruar në listën e zgjedhësve jashtë vendit si ia mohon të drejtën ti të votojë këtu brenda? Sepse ai do të votojë atje. Ti duhet t'ia krijosh të paktën këtë të drejtë.

**Z. D. Çaka:** Atëherë në momentin e votimit duhet detyrimisht të bëjmë kontrollin e vlefshmërisë së dokumentit...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Z. M. Çakaj:** Ka shprehur vullnetin të votojë jashtë vendit, nga Italia...

**Z. D. Çaka:** Si do e verifikosh ti vlefshmërinë e dokumentit në momentin e votimit, nuk jemi në kushtet e Shqipërisë që kemi një Komision qendre votimi e përfaqësues të partive politike që e vlerëson vlefshmërinë e dokumentit. Kujt do t'ia lëmë ne në momentin e dytë përcaktimin dhe nëse është dokumenti i vlefshëm do t'ia lëmë një përfaqësuesi ose një punonjësi të Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve ta bëjë këtë?

**Z. M. Çakaj:** Po shumë mirë do të ishte.

**Z. D. Çaka:** Po pse nuk keni besim te administrata t'i bëjë dhe administrimin e proceseve zgjedhore, strukturat e poshtme të administrimit?

**Z. M. Çakaj:** Shumë mirë do të ishte Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve ta bëjë këtë, verifikimin e vlefshmërisë

**Znj. I. Nano:** Ta bëjë KQZ-ja dhe pastaj çfarë ndodh..

**Z. D. Çaka:** Zonja Kryetare a mundet? Vendimin për shqyrtimin që ne të lejojmë një aplikim të qytetarit me çfarëdo lloj dokumenti të vlefshëm apo të pavlefshëm në momentin e parë, por duhet të kemi element pengues çeku (kontrolli), në momentin e listës përfundimtare në mënyrë pasi të merret ai vendim të jetë apo jo në listë, mos t'i digjet tërësisht mundësia për të votuar fizikisht në Shqipëri, por ndërkohë ne dhe krijojmë një çek për të përcaktuar nëse në ditën e votimit ky zgjedhës e ka apo jo të vlefshëm dokumentin e identifikimit sepse nëse ne do të fusim të gjithë zgjedhësit që kanë dokumenta të skaduar në listë, automatikisht atëherë e para, pyetja ime: si do identifikojmë ne që në ditën e votimit a është i vlefshëm ky dokument apo jo? E dyta, nëse nuk bëhet një vlefshmëri gjatë kësaj

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

periudhe si do t'ia rivendosim të drejtën e mohuar që ai të votojë në datën e zgjedhjeve në Shqipëri?

**Z. M. Çakaj:** Atëherë po në rastin kur një shtetas, më fal meqë bën këto pyetje, po kur një shtetas e ka dokumentin e identifikimit në momentin e regjistrimit po i skadon para votimit, a po i shkel ti të drejtën..

**Z. D. Çaka:** Jo, nuk i skadon përpara votimit sepse votimi...

**Z. M. Çakaj:** zotëri për ty është i rëndësishëm regjistrimi apo votimi?

**Z. D. Çaka:** ...votimi nuk është një datë për zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është një periudhë është njësoj Dritan Çakës. I skadon ...

**Z. M. Çakaj:** Pse e kërkon verifikimin...

**Znj. H. Vukaj:** I skadoi në fillim të asaj periudhe, do t'ia mohosh ti?

**Z. D. Çaka:** ...në momentin që është dita e votimit i skadon karta ose pasaporta, atë ditë po ai voton, ndërkohë ne nuk kemi një ditë në këto momente dhe kemi deru në 60 ditë dhe në qoftë se kjo 60 ditë do të konsiderohet, është ditë votimi 60 ditëshe...

**Znj. H. Vukaj:** Pra, ju thoni ai që është atje në Amerikë apo në Kanada në këtë 60 ditësh, në këtë periudhë ai paskërka mundësinë që në qoftë se konstaton në ditën 1 që e ka të skaduar ka mundësinë që në 59 ditët e tjera në dispozicion të rinoj dokumentin? Ai në Kanada? Çfarë je duke thënë z. Çaka?

**Z. D. Çaka:** Jo e ke gabim, nuk e kuptove.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Znj. H. Vukaj:** Jo e kam kuptuar shumë mirë

**Z. D. Çaka:** Jo s'e ke kuptuar.

**Znj. H. Vukaj:** Absolutisht, shembulli që sapo sollët e kam kuptuar jashtëzakonisht shumë mirë.

**Z. D. Çaka:** Ose s'dëgjon dhe s'të pëlqen ta dëgjosh është tjetër gjë...

**Znj. H. Vukaj:** Unë nuk kuptoj arsyen pse doni të miksoni këtë akt me akte të paqena, sot rendi i ditës është...

**Z. D. Çaka:** Rëndësi ka procesi, rëndësi ka të votojë...

**Znj. H. Vukaj:** ..të nderuara media rendi i ditës sot është..

**Z. D. Çaka:** ...që zgjedhësi të shkojë të votojë..

**Znj. H. Vukaj:** ....për miratimin e listës, pra për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit...

**Z. D. Çaka:** Jo, jo rëndësi ka procesi i votimit, të shkojë e drejta e tij në vend...

**Znj. H. Vukaj:** Ky është rendi i ditës, nuk është votimi, nuk është fare..

**Z. D. Çaka:** Kështu që atë...

**Znj. I. Nano:** T'ia japim fjalën përfaqësuesit...

**Znj. H. Vukaj:** Kur të mbarojmë ne do t'ia japim fjalën përfaqësuesit..

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Z. D. Çaka:** Ky ishte propozimi im, nëse ju e vlerësoni hajde ta diskutojmë që të ketë një miksim...

**Znj. H. Vukaj:** Diskutoje me Komisionerin se ai është përfaqësuesi të aktit të..

**Z. D. Çaka:** Unë nuk kam me kë e diskutoj, unë e diskutoj me kolegët që kam në këtë panel.

**Znj. H. Vukaj:** Po s'është në rend dite more zotëri

**Z. D. Çaka:** Jo është në rend dite propozimi që lista të mbylllet.

**Znj. H. Vukaj:** Nuk është në rend dite.

**Z. D. Çaka:** Dakord, në qoftë se ju e përcaktoni rendin e ditës dakord!

**Znj. H. Vukaj:** Shiko mirë se çfarë ke përpara në rendin e ditës!

**Znj. I. Nano:** Znj. Xhina, pastaj z. Nuri.

**Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS:** Faleminderit znj. Kryetare! Sa i takon diskutimeve, të gjithë ne bashkohemi në një pikë që sa i takon i takon regjistrimit është vërtet është e ligjshme që një shtetas mund të regjistrohet me çdo dokument që ka në atë moment, problematika qëndron te akti që ne kemi përpara, vërtet akti është për regjistrimin e shtetasve që jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë, por më lejoni t'ju them siç e përsërita dhe dje, fryma e aktit të jep të kuptosh, që do ta lexonte që ky moment regjistrimi lidhet me automatikisht me momentin e votimit sepse nuk gjej në asnjë moment gjatë aktit sesi bëhet një kontroll i dyfishtë sesi ky shtetas.. regjistrohet me një dokument që mund të jetë i skaduar etj., por që është i vlefshëm për identifikim i kontrollohet nëse akti është i vlefshëm apo jo,

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

ai me tē cilin éshtë regjistruar. Po ta vëmë re aktin që kemi nē fryshten e tij, nē pikën 6 tē aktit sa i takon sesionit 5 nē mos gaboj përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit, etj., na thotë nē një frazë tē tij “Lista e zgjedhësve pas përfundimit tē procesit nuk ndryshon nē asnje rrëthanë”, tanjura tē pyes administratën, çfarë nënkuuptojnë me këtë, çfarë nënkuuptojnë me faktin që lista e zgjedhësve nuk ndryshon nē asnje rrëthanë? Kjo listë do tē jetë lista që do tē shërbejë pér momentin e votimit, pra gjithë këta shtetas që janë nē këtë moment nē këtë listë kanë tē drejtën e votimit, bëhet më ndonjë kontroll? Ju thatë që keni filluar po punoni me aktet e tjera, keni parashikuar ndonjë kontroll tē dyfishtë tē shtetasve që do tē janë nē listën përfundimtare tē votimit? Sepse nga akti që ne kemi rezulton që momenti i regjistrimit tē çon direkt te lista përfundimtare e zgjedhjeve, nuk ka asnjë segment tē këtij akti që bëhet një kontroll gjatë këtij afati 120 ditor nëse këta shtetas kanë apo jo dokument tē vlefshëm identifikimi sepse vërtet kemi tē miratuara parimet dje, por një parim mjaft i rëndësishëm që ka tē bëjë me, po ta kishin miratuar, parimi i ligjshmërisë. Ligjshmëria éshtë ajo që duhet tē udhëheqi aktet, tē udhëheqi fryshten e çdo akti që miratohet nē këto momente nē këtë Komision. Neni 105 i Kodit Zgjedhor përcakton qartë momentin e votimit dhe ajo që ne detyrohem para së gjithash, tē respektojmë ligjshmërinë e çdo akti dhe nuk mundemi që me një akt normativ tē shkelim dispozitat e Kodit Zgjedhor, aq më tepër ato kushtetuese. Sa i takon listës së zgjedhësve nuk mund tē pretendojmë që jemi nē kushte tē barabarta me listën e zgjedhësve që hartohet nē shtetin shqiptar. Pra, jemi duke folur pér një procedurë që éshtë vërtet e veçantë, éshtë një procedurë ndryshe nga tē tjerat dhe nëse nē shtetin shqiptar lista e zgjedhësve mund tē korigjohet deri 24 orë para datës së zgjedhjeve, këtu mundemi vetëm 60 ditë para datës së zgjedhjeve që tē bëhen rishikime sepse vetë Komisioneri u shpreh që lista nuk mund tē ndryshohet më, kështu që përsa kohë apriori kuptohet

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 19.10.2024*

dhe nuk bëjmë sikur s'e kuptojmë dot që ky moment lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me momentin e votimit, nuk mundemi ta bëjmë këtë ndryshim ligjor. Nëse biem të gjithë dakord që dhe unë jam shumë dakord që regjistrimi nuk mund të kufizohet me vlefshmërinë e një akti, por duhet të gjenden mekanizmin që lista mbas regjistrimit të kontrollohet për vlefshmërinë e dokumentit, dakord hajde dhe kalojmë këto ndryshim por duhet të gjejmë mekanizmin dhe ky është momenti që duhet gjetur për sa kohë që na çon në pikën 5 apo 6 ku thotë lista nuk mund të ndryshojë më dhe kjo listë është ajo që të jep të drejtën të shkosh, të vijë zarfi dhe të votosh pa u bërë mëasnjë verifikim. Faleminderit!

**Z. M. Çakaj:** Më fal e nderuar, atëherë shiko që të jemi korrekt me Kodin Zgjedhor. Lista e zgjedhësve brenda vendit nuk ndryshon 24 orë përpara, ndryshon vetëm me vendim gjykate, edhe lista e zgjedhësve jashtë vendit ka mundësi të ndryshohet me vendim gjykate. Edhe në listën e zgjedhësve brenda vendit ka një afat të parashikuar nga ligjvënsi në mos gaboj 40-45 ditë, tej të cilës nuk mund të ndryshojë lista e zgjedhësve dhe nëse një zgjedhës gjen pasaktësi ose nuk e gjen emrin në listë do i drejtohet gjykatës përkatëse dhe me vendim gjykate, i cili merret shumë shpejt, janë shkurtuar afatet se ka gjyqtarë në dispozicion të gatshëm e fiton tëdrejtën me vendim gjykate për t'u përfshirë në listën e zgjedhësve, për të votuar, të njëjtin parashikim ligjor ka bërë ligjvënsi edhe për listën e zgjedhësve jashtë vendit. Në rastin konkret ajo çfarë po shtrohet këtu për diskutim është vetëm hartimi i listës së zgjedhësve, në procedurat e votimit unë jam i bindur që Komisioneri, së pari do të kthehet në shinat e ligjshmërisë dhe do të propozojë, do të materializojë dhe shqetësimin qoftë të partive politike, qoftë dhe të kolegëve këtu. Më duket se qenka i njëjtë shqetësimi se unë nuk e ndaj atë shqetësim, për mua rëndësi së pari ka që ky proces të jetë sa më masiv sepse pothuajse gjysma e shqiptareve jetojnë jashtë vendit, pra 2.4 në Shqipëri në bazë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 19.10.2024*

të rezultateve të Censusit, as një vit s'ka Censusi që është kryer dhe 2.2 jetojn jashtë, pra gjysma e shqiptareve janë jashtë Shqipërisë. Të drejtën kushtetuese e kanë si ata brenda, si ata jashtë, ky ishte vullneti i ligjvënësit. Tani nëse vullnetin e ligjvënësit ne duam e japim me Kuvend dhe po e marrim me vota këtu, mua nuk më shkon. Në gjykimin dhe në vlerësimin tim jam i bindur që nëse Kuvendi do donte ta kufizonte këtë të drejtëdo ta kishte materializuar në ndryshimet përkatëse të datës 26 korrik, nuk e ka bërë këtë gj. Që do të thotë hajde t'i hapim rrugë procesit, le t'i regjistrojmë zgjedhësit dhe të gjejmë modalitetet në projektaktin për votimin e shtetasve, ka shumë mundësi eksplorimi, përfshirë dhe futjen e një dokumenti ose përfshirë edhe një modus operandi nga administrata e KQZ-së apo nga PER-i në lidhje me këtë. Nëse nuk nuk do ketë zgjatje ose nëse do paraqitet problematika ne nuk e dimë sot sesa shtetas do regjistrohen, sesa shtetas do shprehin vullnetin dhe përpos kësaj ne nuk e dimë se dhe shtetasit që do regjistrohen e kanë të vlefshëm dokumentin e identifikimit, e kanë shprehur dhe vullnetin, për arsy objektive që do të duhet t'i diskutojmë në aktet e mëpasshme mund t'u duket e shtrenjtë kosto e postës. Për mua të jetë falas ky proces për shtetin shqiptar se është detyrim i shtetit shqiptar t'ia mbulojë gjithë këto. Nuk e di sesi do vendosim në këtë Komision, por për gjithfarë arsyesh objektive kjo e drejtë kushtetuese edhe pse mund ta ketë shprehur vullnetin, edhe pse mund t'i ketë dokumentat e identifikimit të vlefshme, nuk do të ushtrohet, pra shtetasi shqiptar mund ta ketë shprehur vullnetin mund të jetë regjistruar në PER, mund t'i shkojë dhe zarfi dhe nuk e poston mbrapsht, është praktikë e të gjitha vendeve që e praktikojnë të drejtën e votës nga jashtë vendit, rreth 10 ose 15 % e shtetasve të cilët janë regjistruar nuk e ushtrojnë këtë të drejtë vote për arsy objektive të tyre, personale, subjektive, objektive. Kështu që së pari ne këtë të drejtë ia kemi dhënë me ligj, hajde t'ia japim dhe me akte nënligjore, të regjistrohen shtetasit,

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

kur të vijë momenti për një javë, për dy javë se dhe ne i kemi me afat aktet hajde ulemi e gjejmë zgjidhjen për të drejtën e votës dhe të drejtën e votës në përputhje dhe me Kodin Zgjedhor, në përputhje dhe me garancitë që duan të gjitha palët, por ky akt nuk duhet të bllokohet me këtë. Nuk mund të kushtëzohet ky akt, ndërkohë që unë nuk e gjej me bazë ligjore. Sinqerisht nuk e gjej me bazë ligjore dhe propozimi është i paligjshëm që ka bërë Komisioneri Shtetëror, dokument identifikimi i pavlefshëm është i pambështetur edhe në ligj, në nenin 44 të Kodit Zgjedhor, edhe në nenin 46.

**Znj. I. Nano:** Z. Nuri para se t'ju jap fjalën që e keni kërkuar më herët, mundet të them diçka në raport me këto që sapo kolegu Çakaj tha. Paraprakisht unë do doja që nëpërmjet leximit të Kodit Zgjedhor është një nen që e lexoi dhe kolegu: "Zgjedhësit që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvend duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kod dhe aktet nënligjore nën zbatim të tij." Kështu që padyshim kemi të bëjmë me një të drejtë kushtetuese, po e cila rregullohet me ligj, ligji për më tepër na ka dhënë të drejtën për të nxjerrë akte nënligjore dhe ne pikërisht në këtë fazë jemi. Në fazën e shqyrtimit të një nga akteve nënligjore. Kolegu Çakaj pak më herët tha ta kapërcejmë këtë moment, çështjen e regjistrimit dhe kur të vijë puna tek votimi gjejmë një modus operandi ku të akomodojmë së bashku si të drejtën kushtetuese dhe ligjore por edhe garancitë që kërkojnë palët. Tani këto garanci që kërkojnë palët janë apo s'janë ligjore unë nuk e di, unë prandaj po kërkoj dhe unë. Të lutem znj. Vukaj jam duke komunikuar. Pra, unë jam duke kërkuar një garanci sot që nëse e heq këtu këtë dokumentin e vlefshëm ta vë në këtë akt, po këtu, po sot dhe ju .. sot këtë gjë mua, kur të vijë momenti i votimit unë kam një pyetje sot, mënyra gjenden pafund, po pyetja themelore që shtrohet

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

është a do të votojnëme dokument të pavlefshëm shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit apo jo? Nëse ma thoni publikisht sot po ose jo, atëherë edhe unë vlerësoj qëndrimin tim. Jemi 5 anëtarë të Komisionit Rregulator, kemi dy përfaqësues të partive politike dhe ajo që z. Nuri e tha, z. Çakaj e tha potencialisht mund të ketë një akt normativ të qeverisë po këtë gjë nuk e dimë sot, s'kemi një datë zgjedhjeje akoma, s'kemi dekret presidenti dhe e di nga eksperienca që ai akt del dikur vonë. Pra, a mund të thotë dikush sot, unë them po duhet të jenë me dokumenttë vlefshëm, po këtë s'po ma thotë asnjëri nga ju.

**Z. M. Çakaj:** Më falni, doni një përgjigje për këtë?

**Znj. I. Nano:** Patjetër!

**Z. M. Çakaj:** Këtë që ju sapo e shtruat për diskutim, referuar gjithë kuadrit ligjor shqiptar ka vetëm një institucion që e ka në dorë është qeveria e Shqipërisë.

**Znj. I. Nano:** Qeveria e Shqipërisë ka në dorë të shtyjë vlefshmërinë e afatit po Kodi Zgjedhor të thotë i vlefshëm, pa një dokument të vlefshëm nuk voton dot.

**Z. M. Çakaj:** Në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin, për vitin 2021 dhe në zgjedhjet vendore të vitit 2023 është, me vendim qeverie është shtyrë vlefshmëria...

**Znj. I. Nano:** Me rregull treshi do ta bëjmë ne?

**Z. M. Çakaj:** Jo, po nuk e kemi ne në dorë ta themi, e ka qeveria, ju e kërkonit në këtë sallë, nuk e ka asnjë në këtë sallë tagrin të themi vendos

**Znj. I. Nano:** Prandaj po them... Nuk po kërkoj shtyrjen e vlefshmërisë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Z. M. Çakaj:**...voton shtetasi shqiptar me banim brenda apo jashtë vendit voton me dokumenta të skaduara apo voton me dokumenta të vlefshme, nuk e kemi ne në dorë, e ka Kodi.

**Znj. I. Nano:** E ke në dorë sepse e ka Kodi Zgjedhor .

**Z. M. Çakaj:** Nuk e kemi ne në dorë këtë.

**Znj. I. Nano:** Kush e ka në dorë? Qeveria shtyn vlefshmërinë pra nënkupton, qeveria me akt normativ, pra e bën të vlefshëm, të thotë që mbetet në parimin që duhet të jetë një dokument i vlefshëm.

**Z. M. Çakaj:** Atëherë shumë dakord. Pse e kërkonit këtu ju? Pse e kërkonit këtu tek ne? Kur e ka qeveria dhe Kuvendi.

**Znj. I. Nano:** Jo! E ka Kodi Zgjedhor, nuk e ka qeveria dhe Kuvendi ka në dorë jo..

**Z. M. Çakaj:** Po çfarë po kërkonit, të marrim kompetencat e tyre?

**Znj. I. Nano:** Jo z. Çakaj ti më kuption shumë mirë, unë shtroj një pyetje, në konceptin si jurist dhe si anëtar i Komisionit Rregulator zgjedhesi jashtë vendit...


**Z. M. Çakaj:** Në kuptim të këtij Komisioni...

**Znj. I. Nano:** ...ta mbaroj pyetjen pastaj m'u përgjigji.

**Z. M. Çakaj:** Mirë ma bëj pyetjen.

**Znj. I. Nano:** Pra, zgjedhesi me banim jashtë vendit do të votojë me një dokument të vlefshëm apo me një dokument që i ka mbaruar afati i vlefshmërisë?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Z. M. Çakaj:** Atëherë, në kuqtimin tim si jurist për hir të të gjithë parimeve çfarë parashikon Kodi Zgjedhor si dhe për hir të parimit të së drejtës kushtetuese të të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur duke qenë se po avancon dhe teknologja unë personalisht mendoj që zgjedhësi mund të votojë pas asnjë lloj dokumenti, mjafton që të identifikohet në mënyrë të saktë, në mënyrë biometrike në qendrën e votimit dhe ka të drejtën të votojë, pra në mënyrë që pajisja nëse një pajisje e cila lexon gjithë komponentët e zgjedhësit, ta njohi, ta certifikojë dhe s'ka nevojë fare qoftë me shenja gishti, qoftë me biometrinë e fytyrës dhe s'ka nevojë fare të ketë dokument të vlefshëm apo të pavlefshëm. E drejta kushtetuese dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk paracakton asnjë kufizim për të ushtruar të drejtën e votës, mjafton...

**Znj. I. Nano:** Po parashikon Kodin Zgjedhor...

**Z. M. Çakaj:** ...vetëm nëse është hequr me vendim gjykate...

**Znj. I. Nano:** Parashikon Kodi Zgjedhor.

**Z. M. Çakaj:** Nuk parashikon asnjë kufizim, kështu që...

**Znj. I. Nano:** është e drejtë, vetëm e drejta për të mos iu nënshtuar torturës është e drejtë e pakufizuar.

**Z. M. Çakaj:** Mirë, dakord, unë jam i qartë që ju ..këto kufizimet

**Znj. I. Nano:** E pra gjithë të tjerat rregullohen, vetëm ajo është e drejtë absolute gjithë të tjerat janë të kufizueshme.

**Z. M. Çakaj:** Tani a jemi këtu..

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Znj. I. Nano:** Të gjitha të tjera rregullohen me ligj, ligji thotë rregullohen me akte nënligjore.

**Z. M. Çakaj:** Po po e qartë, tani a jemi këtu për të

**Znj. I. Nano:** Përndryshe do kishte votuar diaspora dhe në 2021...

**Z. M. Çakaj:** Më fal, ne po i vëmë kufizime te procesi i regjistrimit që s'e ka ligji këtë gjë, është i paligjshëm ky propozim!

**Znj. I. Nano:** Jo, nuk është i paligjshëm!

**Z. M. Çakaj:** Është i paligjshëm ky propozim

**Znj. I. Nano:** Ti sot po më thua unë nuk e di, po të jetë për mua vetëm me një dokument.

**Z. M. Çakaj:** Jo, jo, për regjistrimin po them.

**Znj. I. Nano:** Hajde të kalojmë këtë moment se kur të vijë votimi unë prapë nuk do ta votoj, këtë je duke thënë?

**Z. M. Çakaj:** Ju e nderuar, jo nuk thashë atë, të lutem mos vini fjalë në gojën time që s'i kam nxjerrë..

**Znj. I. Nano:** Sepse për mua the të votohet vetëm me një dokument identifikimi atë do ta dëgjosh më pas.

**Z. M. Çakaj:** Po e kam dëgjuar, e kam të qartë se çfarë nxora.

**Znj. I. Nano:** Prapë nuk mund më kthyet përgjigje pyetjes.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike*

*të Komisionit Rregullator*

*Dt. 19.10.2024*

**Z. M. Çakaj:** Mos shpikni sepse nuk e thashë unë atë.

**Znj. I. Nano:** Unë po shpik? Ktheje shiritin 3 minuta më përpara.

**Z. M. Çakaj:** Unë thashë për mua mund të votoni, teknologja ka ecur mund të votojë vetëm me biometri, mjafton të identifikohesh.

**Znj. I. Nano:** Po kemi dhe Kod Zgjedhor, këtë Kod Zgjedhor kemi në fuqi.

**Z. M. Çakaj:** A më pyetët për të ardhmen edhe për këtë të ktheva përgjigje.

**Znj. I. Nano:** Unë për këtë vit, 2025.

**Z. M. Çakaj:** Nëse ju jeni të sinqertë në këtë proces atëherë hajde t'i regjistrojmë t'i japim të drejtën, mos nxirrni artifica të paligjshme, është e paligjshme..

**Znj. I. Nano:** Jo nuk janë. Janë logjike të gjitha të ligjshme dhe të justifikuara me diskutimin në vijim.

**Z. M. Çakaj:** Të lutem, më gjej bazën ligjore.

**Z. D. Çaka:** Gjeni bazën ligjore që mund të votojë çdo qytetar me dokument me dokument të pavlefshëm.

**Z. M. Çakaj:** Nuk jemi te akti i votimit zotëri..

**Znj. I. Nano:** Sapo bëre një deklaratë publike për këtë gjë.

**Z. M. Çakaj:** Nuk jemi te akti i votimit...

**Znj. H. Vukaj:** Neni 3, Parime të përgjithshme, “Çdo shtetas shqiptar që ka mbushur moshën 18 vjeç qoftë dhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim rrace, etnie,

*Zbardhi materialin audio*

*Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike*

*të Komisionit Rregulator*

*Dt. 19.10.2024*

gjinie, gjuhe, bindje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod". Zhbëje këtë po deshe z. Çaka.

**Z. D. Çaka:** Ne jemi me rregullat e parashikuar në këtë Kod, ne jemi institucion rregulator që me aktet tona kemi vendosur që një qendër votimi nuk e pranon zgjedhësin me dokument të pavlefshëm.

**Znj. H. Vukaj:** Zotëri keni një shqetësim ju që është përtej kësaj kompetencë?

**Znj. I. Nano:** Duhet ta lexosh Kodin dhe ta zbatosh, jo ta interpretosh

**Znj. H. Vukaj:** Unë sapo e lexova Kodin.

**Z. D. Çaka:** procesi zgjedhor, pra ti shkosh fizikisht në...

**Znj. H. Vukaj:** Interpretimin ndaj është vënë në teknikë legislative dhe ne si juristë e dimë shumë mirë...

**Z. M. Çakaj:** Ju po paragjykoni procesin, pse e paragjykoni procesin.

**Znj. H. Vukaj:**..për t'i dhënë mundësi situatave. Ka shqetësim znj. Nano? Le të thërrasë një përfaqësues nga ekzekutivi dhe ta pyesi këtu përpara shqiptarve nëse ka shqetësim sepse kjo është përtej nesh. Ne duam të votojmë të gjithë shqiptarët znj. Nano. Absolutisht duhet të votojnë të gjithë shqiptarët që ndodhen jashtë shtetit, pra duhet të regjistrohen dhe duhet të votojnë të gjithë shqiptarët, masivisht. Por, mos kërko gjëra të kushtëzuara të cilat bëni sikur me një dorë ia jepni qytetarëve shqiptarë dhe nga ana tjetër na nxirrni ca mekanizma të cilët janë mekanizma bosh për këtë lloj tryze dhe për këtë lloj rend dite. Thirr një përfaqësues të ekzekutivit dhe merrja pohimin atij dhe pastaj të gjithë do të

*Zbardhi materialin audio*

*Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

diskutojmë kur të vijë propozimi i z. Celibashi se çfarë përmban ai akt në lidhje me votimin.

**Znj. I. Nano:** Do të diskutojmë, nuk e kemi të qartë. Do zbatojmë Kodin Zgjedhor apo jo?

**Znj. H. Vukaj:** Në qoftë se ju e keni të qartë dhe i keni bërë draftin e Z.Celibashi bashkarisht atëherë kjo është çështje tjetër, vetëm unë me kolegun Çakaj nuk paskemi dijeni për draftin që vijë për votimin. Ne të dy s'paskemi dijeni për draftin, në qoftë se ju i bëni draftet bashkë me z. Celibashi, atëherë kjo është çështje tjetër..

**Znj. I. Nano:** Unë ato parime që lexova, i ndjek me çdo akt që vjen dhe gjithë normat që ka Kodi.

**Znj. H. Vukaj:** A do ndjekim parimet? Parimet janë burojnë nga Kushtetuta nuk mundet moj zonjë, prandaj jemi këtu për të gjetur mekanizma dhe jo për të nxjerrë pengesa. Hajde dhe gjejmë mekanizma, kaloni sot mundësi që të gjithë shtetasit që ndodhen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të regjistrohen, pastaj çështjen e votimit e kemi në një moment të dytë. Të shikojmë si do na vijë drafti. Në qoftë se ju e dini që në atë draft, pastaj do kesh kushtëzime të tjera dhe pengesa të tjera, na i thoni sepse ne..

**Znj. I. Nano:** Jo pengesë, çfarë ka ligji

**Z. D. Çaka:** Nuk e thoni me gojë, si ta kemi garancinë ne se çfarë do ndodhi nesër që thoni ju. Neni 105 e thotë qartë, pas hyrjes së zgjedhësit në qendrën e votimit, zgjedhësi thotë emrin, paraqet para KQV-së një dokument të vlefshëm të identifikimit...

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Z. M. Çakaj:** Nuk jemi aty i nderuar koleg.

**Znj. H. Vukaj:** S'jemi fare aty zotëri.

**Z. D. Çaka:**...ose pasasaportë, pra dokument zyrtar të vlefshëm.

**Z. M. Çakaj:** Nuk jemi te votimi, jemi të regjistrimi.

**Znj. I. Nano:** Po regjistrimi është i lidhur me listën e zgjedhësve..

**Z. D. Çaka:**...vendosni në kundërshtim me Kodin, është e thjeshtë, nuk e kemi përcaktuar ne. Kush do e verifikojë vlefshmërinë?

**Znj. I. Nano:** ..në qoftë se ti thua modus e ke tani, vendose tani.

**Znj. H. Vukaj:** Hidh në votim propozimet që kemi lënë përgjysëm. Zonjë nuk mund të më kushtëzoni.

**Znj. I. Nano:** Ju lutem jemi duke folur katër veta..

**Z. D. Çaka:** Garanci për qytetarin


**Z. M. Çakaj:** Çfarë garancie, të shprehi vullnetin. Këtë ka thënë ligjvënësi të shprehi vullnetin për t'u regjistruar në listën e zgjedhësve...

**Z. D. Çaka:** Sipas rregullave...

**Znj. I. Nano:** Në përputhje me aktet ligjore, po pra rregullin jemi duke bërë

**Z. M. Çakaj:** po pra rregulli, ai shpreh vullnetin dhe është i regjistruar

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverball i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator  
Dt. 19.10.2024*

**Znj. I. Nano:** për mua mund të jetë i ndryshëm ky rregull ndaj do vendosim këtu së bashku cili është rregulli.

**Z. M. Çakaj:** Po pra po pse paske ti të drejtë të pambështetur në Kod...

**Znj. I. Nano:** Së bashku thashë, jo sepse nëse ti thua do gjej një modus nesër gjeje sot këtë.

**Z. M. Çakaj:** Kur të vijë akti e nderuar, ti nuk je në gjykimin dhe shqyrtimin e aktit të votimit

**Znj. I. Nano:** Ke listën e zgjedhësve e cila nuk ndryshon më.

**Z. M. Çakaj:** Atëherë a e keni lexuar këtu?

**Znj. I. Nano:** Nuk mund të lëmë të parregulluar një hap procedural.

**Z. M. Çakaj:** Projektvendimi i sotëm nuk ka lidhje “Për miratimin e rregullave për regjistrim...” a ka këtu votim, a ka procedura votimi?


**Znj. I. Nano:** A e ndërpresim pak? Se tani e bëmë vetëm konferencë për shtyp. Dhjetë minuta dhe e fillojmë prapë.

**Rifillon seanca**

**Ora 14:02**

**Znj. I. Nano:** Atëherë rifillojmë mbledhjen që e ndërpremë para rrëth gjysëm ore. Po e rifillojmë me një njoftim, për ta shtyrë mbledhjen për ditën e hënë, ora do t'ju njoftohet, do të jetë ditën e hënë paradite. Brenda ditës së sotme ose të nesërme do të lutesha, nga administrata diskutimet që janë bërë më herët dhe dje pas

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbal i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregulator*  
*Dt. 19.10.2024*

mbledhjes se e shtymë mbledhjen për të diskutuar, nëse do t'i sillni në formë propozimi për krerët e mëtejshëm do t'ju lutesha t'i dërgoni me shkrim ose mirë do ishte më përpala që të dimë. Besojmë që do të jetë rreth orës 11, 12, gjithsesi do të njoftoheni, pasdreke, me një njoftim zyrtar për zhvillimin e mbledhjes. Nëse do të ketë materiale shtesë, gjithashtu do të dërgohen bashkë me njoftimin zyrtar, kështu që do të luteshim zonja Sekretare e Përgjithshme, në momentin që do të bëj njoftimin si gjithmonë për t'u kujdesur për njoftimin e palëve. Po e mbyllim atëherë mbledhjen për sot. Ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

